



**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**  
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 1635/21; Datë: 07.06.2021

Në bazë të nenit 22, paragrafit 1.3 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.06.2021, merr

**V E N D I M**

- I. Miratohet Rregullorja për për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UShAF.
- II. Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

**A r s y e t i m**

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF, pas elaborimit të draft rregullore në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet DALIPI



Në mbështetje të nenit 22, paragrafit 1.3 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), si dhe në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës, nr. 06/L-082, Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 07.06.2021, miraton

**RREGULLORE  
PËR  
MBROJTJEN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE NË  
UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton parimet e përgjithshme , procedurën dhe masat organizative lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, sigurinë dhe përpunimin e të dhënave personale në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm Universiteti).

**Neni 2**

**Përkufizimet**

1.Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1 Të dhëna personale-çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, elementet me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturor etj.

1.2 Përpunim i të dhënave personale- është çdo veprim ose një sërë veprimesh, të cilat kryhen në të dhënat personale, me apo pa ndihmën e mjeteve automatike siç janë: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi,zbulimi përmes transferimit, shpërndarjes ose mënyrave tjera të vënies në dispozicion, kombinimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi.

**1.3 Përpunimi automatik i të dhënave-përpunim i të dhënave personale duke përdorur mjetet e teknologjisë informative.**

**1.4 Kontrollues i të dhënave - sipas kësaj rregullore është Universiteti, i cili vetëm apo në bashkëpunim me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave apo personi i caktuar me vendim të posaçëm që po ashtu përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit.**

**1.5 Përpunues i të dhënave -është ose janë nëpunësit e kontrolluesit, si dhe personat e autorizuar prej tij, që përpunojnë të dhëna personale per kontrolluesin.**

**1.6 Subjekti i të dhënave personale -është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.**

**1.7 Marrës i të dhënave - është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër të cilit i zbulohen të dhënat personale me një qëllim te ligjshëm.**

**1.8 Pëlqim i subjektit të të dhënave- çdo shprehje e lirë e vullnetit, të dhënë nga subjekti i të dhënave, me të cilin jep pajtimin për përpunimin e të dhënave personale.**

**1.9 Pëlqim me shkrim i subjektit të të dhënave-pëlqimin e dhënë sipas nënparagrafit 1.8 të paragrafit 1 të këtij neni, ku përveç kësaj subjekti i të dhënave duhet të vë nënshkrimin ose shenjën në pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhënave**

**1.10 Pëlqim gojor ose pëlqim tjetër i përshtatshëm i subjektit të të dhënave-pëlqimin sipas nënparagrafit 1.8 të paragrafit 1 të këtij neni, e dhënë gojarisht me anë të mjeteve të telekomunikimit apo mjeteve tjera të përshtatshme (postës elektronike e tjera), përmes të cilit mund të konkludohet në mënyrë të qartë se subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tij ose saj.**

**1.11 Sistem i dosjeve-çdo strukturë e caktuar e të dhënave personale, që është e qasshmenë varësi të kriterëve specifike, pavarësisht nëse struktura është e centralizuar, e decentralizuar ose e shpërndarë në baza funksionale ose gjeografike.**

**1.12 Katalog i sistemit të dosjeve-përshkrimi në detaje i strukturës dhe përmbajtjes të sistemit të dosjeve**

**1.13 Regjistër i sistemit të dosjeve-regjistri i cili mundëson një pasqyrim të detajuar të sistemit të dosjeve.**

**1.14 Bllokim-ndalim i përpunimit të mëtutjeshëm të të dhënave.Vendimi për bllokimin e të dhënave duhet të tregohet në mënyrë të saktë dhe duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale për aq kohë sa ekzistojnë arsyet për bllokim.**

**1.15 Klasifikimi i të dhënave personale-shënjimi i të dhënave personale për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme.**

**1.16 Të dhëna personale të ndjeshme-të dhënat personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësisë fetare, çdo të dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtje që ruhen në pajtim me ligjin.**

**1.17 Kod lidhës-numri personal i identifikimit ose çfarëdo numri tjetër i veçantë i identifikimit të përcaktuar me ligj, lidhur me personin, i cili numër mund të përdoret për zbulimin ose rikthimin e të dhënave personale nga sistemet e dosjeve në të cilat gjithashtu përpunohet kodi lidhës.**

**1.18 Anonimizim-ndryshimi i të dhënave personale në mënyrë të atillë që ato të mos mund të ndërliidhen më me subjektin e të dhënave ose ku ndërliidhja e tillë mund të**

bëhet vetëm me përpjekje, shpenzime ose me kohë shtesë.

### Neni 3

#### Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për mbrojtjen, sigurinë, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale që administrohen në Universitet, në formë shkresore ose elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KREU II PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

### Neni 4

#### Mbrojtja e të dhënave personale

1. Universiteti mbron dhe përpunon të dhëna personale për punonjësit akademik, joakademik dhe të dhëna personale për studentë.

2. Të dhënat personale të subjekteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, përpunohen, mbahen dhe sigurohen në dosje fizike dhe në mënyrë automatike (elektronike).

3. Çdo nëpunës i Universitetit, që merret me përpunimin e të dhënave personale, detyrohet të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, por jo me pak se:

a. Respektimin e parimit për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;

b. Kryerjen e përpunimit në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;

c. Grumbullimin e të dhënave personale për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe kryerjen e përpunimit të tyre në përputhje me këto qëllime;

ç. Të dhënat që do të përpunohen duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;

d. Të dhënat duhet të jenë të sakta nga ana faktike dhe kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;

dh. Të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e të dhënave të personave, për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

## Neni 5

### Qëllimi i përpunimit

Çdo nëpunës i Universitetit, mund t'i përdorë të dhënat personale vetëm për kryerjen e detyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

## Neni 6

### Kriteret e përpunimit të të dhënave personale

1. Nëpunësit e Universitetit, që merren me përpunimin e të dhënave personale, bazohen në kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Nëpunësit që merren me përpunimin e të dhënave, nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

3. Forma e deklaratës së konfidencialitetit i bashkangjitet kësaj rregullore si shtojcë nr.1

4. Të dhënat personale përpunohen vetëm:

a. nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;

b. për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;

c. për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;

ç. për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;

d. për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë;

## Neni 7

### Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme

1. Të dhënat personale të ndjeshme duhet të mbrohen dhe të përpunohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

2. Për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të ndjeshme do të zbatohen parimet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

S. O .

## KREU III

### TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

#### Neni 8

##### Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

1. Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të informohet në hollësi me rastin e përpunimit të të dhënave të tij personale për:

1.1 Identitetin e kontrolluesit të të dhënave;

1.2 Qëllimin e përpunimit

1.3 Bazën ligjore të veprimeve të përpunimit

1.4 Origjinën e të dhënave

1.5 Informacionin për kategoritë e të dhënave personale të grumbulluara

1.6 Informacionin lidhur me marrësin ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale

1.7 Informacionin lidhur me të drejtën për qasje, transkriptim, kopjim, korrigjim, plotësim, bllokim dhe asgjësim të të dhënave personale.

#### Neni 9

##### Përdorimi i kodeve lidhëse

Konform legjislacionit në fuqi, kodi lidhës mund të përdoret për të marrë të dhënat personale në rast se është i vetmi element i të dhënave për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjekteve të të dhënave.

#### Neni 10

##### Zbulimi i të dhënave personale

1. Marrësi i të dhënave bartë shpenzimet për zbulimin ligjor të të dhënave nga ana e kontrolluesit konform legjislacionit në fuqi.

2. Kur zbulohen të dhënat personale, kontrolluesi i të dhënave duhet të sigurojë informacionin se cilat të dhëna janë zbuluar, kujt kur dhe me çfarë baze ligjore.

#### Neni 11

##### Mbrojtja e të dhënave personale të personave të vdekur

Të dhënat personale të personave të vdekur mund t'u zbulohen vetëm marrësve të autorizuar me ligj dhe trashëgimtarëve të tyre ligjor, nëse ata tregojnë interes legjitim dhe personat e vdekur nuk a kanë ndaluar me shkrim zbulimin e të dhënave të tilla.

S.9.

## Neni 12

### Mbrojtja ligjore e të drejtave të subjektit të të dhënave

Subjektet e të dhënave nëse kuptojnë se të drejtat e tyre janë shkelur, mund të kërkojnë mbrojtje ligjore konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KREU IV

### SIGURIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

## Neni 13

### Personat pergjegjes per procedurën e përpunimit

1. Për mbarëvajtjen e procedurës së përpunimit të të dhënave dhe sigurimin e tyre, universiteti konform legjislacionit në fuqi, cakton një zyrtar për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave (më tej: zyrtari).

1.2. Zyrtarin e zgjedh Këshilli Drejtues i Universitetit me vendim të posaçëm dhe është përfaqësues legjitim i kontrolluesit të të dhënave, në këtë rast të Universitetit.

1.3. Zyrtari zgjidhet nga stafi administrativ, i cili ka njohuri në fushën e legjislacionit dhe është i besueshëm.

1.4. Zyrtari është personi i parë kontaktues në Universitet, i cili kontaktohet nga marrësi i të dhënave dhe konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale e fillon procedurën për përpunimin e të dhënave.

1.5. Universiteti ndihmon zyrtarin në kryerjen e detyrës së tij, duke vënë në dispozicion pajisjet dhe kapacitetet tjera.

1.6. Zyrtari është i detyruar të mbajë fshehtësinë e të dhënave personale, me të cilat njoftohet gjatë kryerjes së detyrës.

1.7. Nëse zyrtari nuk i përmbush më tutje kushtet dhe detyrat e përcaktuara sipas kësaj rregullore, shkarkohet nga detyra e tij.

## Neni 14

### Masat për sigurinë e të dhënave personale

1. Universiteti merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale ose jo, fatkeqësive natyrore, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjete apo sisteme elektronike, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Universiteti merr këto masat sigurie:

2.1 Duke mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet aplikative (softuerët), përfshirë edhe

kontrollin e qasjes;

2.2 duke i mbrojtur programet aplikative (souftuerike) që përdoren për përpunimin e të dhënave;

2.3 duke parandaluar çfarëdo qasje të paautorizuar në leximin e të dhënave personale gjatë ruajtjes dhe transmetimit të tyre, përfshirë transmetimin nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit dhe rrjeteve;

2.4 duke siguruar metodat efikase për bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale;

## **Neni 15**

### **Obligimi për sigurimin e të dhënave personale**

1. Kontrolluesi dhe përpunuesit e të dhënave, duhet të kujdesen në çdo kohë që të dhënat të jenë të mbrojtura sipas mënyrës së përcaktuar me nenin 14 të kësaj rregullore.
2. Universiteti për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave, është i obliguar që me vendim të posaçëm të vendos për instalimin e kamerave vëzhguese brenda dhe jashtë objektit.
3. Në hyrje të objektit kontrollohen hyrje-daljet për personat që nuk janë studentë apo staf i universitetit, të cilët duhet të lajmërohen te personi që është përgjegjës nga kompania që ka kontratë me Universitetin për sigurinë e objektit.
4. Secili person sipas paragrafit 3 të këtij neni, që hyn në objekt duhet të plotësoj formularin për vizitë dhe i njejti pajiset me një kartelë ku identifikohet si vizitor.

## **KREU V SISTEMI I DOSJEVE**

### **Neni 16**

#### **Katalogu i sistemit të dosjeve**

Universiteti konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, krijon për secilin sistem të dosjeve një përshkrim të detajuar i quajtur katalog i sistemit të dosjeve.

### **Neni 17**

#### **Regjistri i sistemit të dosjeve**

Universiteti për të mundësuar një pasqyrim të detajuar të sistemit të dosjeve, konform legjislacionit në fuqi krijon një regjistër të sistemit të dosjeve.

## **KREU VI**

### **DISPOZITAT NDËSHKUESE**

### **Neni 18**

**Shkeljet e përgjithshme gjatë procedurës së përpunimit të të dhënave**



Nëse përpunuesit e të dhënave, gjatë përpunimit shkelin dispozitat ligjore, do të denohen konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe në raste të rënda edhe konform kodit penal të Republikës së Kosovës.

## KREU VII

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 19

##### Fillimi i zbatimit të rregullores


1. Kjo rregullore fillon së zbatuari dhe hyn në fuqi me datën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
2. Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, vlejné dispozitat e ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave të Republikës së Kosovës.

#### Neni 20

Me hyrjen të fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UShAF nr. 277/16, dr. 25.04.2016.

Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Kryesues i Këshillit Drejtues



## SHTOJCA NR.1

### DEKLARATË E KONFIDENCIALITETIT

Deklaroj me përgjegjësi morale dhe penale, se gjatë dhe pas kryerjes së punëve të kontraktuara, do të ruaj dhe mbroj çdo fshehtësi me të cilat do të njihem gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Deklaruesi  
Emri dhe mbiemri(nënshkrimi)

---